

LIGJI NR. 08/L-035

**PËR NDYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-017 PËR
NDIHMË JURIDIKE FALAS**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-017 PËR
NDIHMË JURIDIKE FALAS**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr.04/L-017 për Ndhimë Juridike Falas.

Neni 2

Pas nenit 10 të ligjit bazik, shtohet një nen i ri 10/A, me tekstin si në vijim:

Neni 10/A

Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike falas

1. Pavarësisht nga kriteret e kërkuara në nenin 8 dhe 9 të ligjit bazik, ndihma juridike falas i ofrohet:

1.1. personave të dhunuar seksualisht gjatë luftës në Kosovë në vitet 1998-1999;

1.2. viktimave të dhunës në familje;

1.3. viktimave dëshmitare të dhunës, të cilët janë në varësinë e viktimave të dhunës në familje;

1.4. viktimave të dhunës në baza gjinore;

1.5. viktimave të cilitdo lloji të dhunës seksuale, përfshirë dhe ngacmimin seksual;

1.6. viktimave të trafikimit me qenie njerëzore;

1.7. viktimave të mitur;

1.8. fëmijëve që jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;

1.9. fëmijëve nën kujdestari që kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;

1.10. personave të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent sipas ligjit në fuqi për mbrojtje nga diskriminimi;

1.11. Gazetarëve, gazetarëve të pavarur, fotoreporterëve, kameramanëve dhe redaktorëve që punojnë në/për media të licencuara nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM) dhe/ose në media anëtare në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK).

2. Ndihma juridike falas për kategoritë e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni përfshinë shërbimet si në vijim:

2.1. informatat dhe këshillat juridike lidhur me procedurat ligjore;

2.2. përpilimin e shkresave dhe çdo ndihmë teknike që ka të bëjë me kompletimin e lëndës;

2.3. përfaqësimin në procedurën penale dhe civile;

2.4. mbrojtjen dhe përfaqësimin në të gjitha fazat e procedurës penale.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr.08/L-035
9 shkurt 2022**

Shpallur me dekretin Nr. DL-70/2022, datë 24.02.2022 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani-Sadriu